LIGJ
Nr.10 372, datë 10.2.2011

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN NDËRMJET QEVERIVE TË VENDEVE PJESËMARRËSE TË BASHKËPUNIMIT EKONOMIK TË DETIT TË ZI (BEDZ) PËR BASHKËPUNIMIN NË NDIHMËN DHE PËRGJIGJEN NDAJ EMERGJENCAVE TË FATKEQËSIVE NATYRORE OSE TË SHKAKTUARA NGA NJERIU DHE NË PROTOKOLLIN SHTESË TË SAJ

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në marrëveshjen ndërmjet qeverive të vendeve pjesëmarrëse të Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BEDZ) për bashkëpunimin në ndihmën dhe përgjigjen ndaj emergjencave të fatkeqësive natyrore ose të shkaktuara nga njeriu, bërë më 15 prill 1998, dhe në protokollin shtesë të saj, bërë më 20 tetor 2005.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6900, datë 22.2.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
MIDIS QEVERIVE TË VENDEVE PJESËMARRËSE TË BASHKËPUNIMIT EKONOMIK TË DETIT TË ZI (BEDZ) MBI BASHKËPUNIMIN NË NDIHMËN DHE PËRGJIGJEN NDAJ SITUATAVE EMERGJENTE NË FUSHËN E FATKEQËSIVE NATYRORE DHE ATO TË SHKAKTUARA NGA DORA E NJERIUT

Qeveritë, palë në këtë Marrëveshje, të referuara si "palë",

duke marrë parasysh gjasat për shkaktimin e ndonjë situate emergjente, të cilët palët nuk mund t'i eliminojnë me forcat dhe mjetet e tyre, gjithashtu dhe kërkesën që rrjedh nga ky fakt për veprime të koordinuara të palëve, që kanë si qëllim parandalimin dhe përgjigjen ndaj situatave emergjente;

duke dëshiruar të shtrijnë më tej bashkëpunimin e zhvilluar rajonal për të siguruar ndihmën në rast situatash emergjente dhe për të treguar përpjekje të përbashkëta për të siguruar ndihmë të koordinuar për popullsinë e prekur;

duke mbështetur përpjekjen e Kombeve të Bashkuara në fushën e ndihmës ndërkombëtare ndaj situatave emergjente;

duke respektuar dhe njohur në përgjithësi rregulloret dhe rregullat e pranuara që ekzistojnë në kuadër të organizatave të ndryshme ndërkombëtare, rajonale dhe nënrajonale, konventat dhe marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare;

si dhe *me qëllimin* për të kontribuar në përgatitjen e legjislacionit të duhur kombëtar;

duke nxitur më tej bashkëpunimin në fushën e ndihmës ndërkombëtare ndaj situatave emergjente;

bazuar në iniciativat e ndërmarra në Konferencën e Parë të Kryqit të Kuq të Detit të Zi dhe Shoqatat e Gjysmëhënës së Kuqe (1997);

duke shprehur mbështetjen e tyre ndaj idesë për krijimin e një qendre ndërkombëtare shpëtimi të Detit të Zi, duke përdorur eksperiencën e përftuar nga vendet e BEDZ-it dhe të tjera qendra të ngjashme ndërkombëtare,

bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Fusha e aplikimit

1. Kjo Marrëveshje vendos parime dhe kuadro ligjorë të aktiviteteve të koordinuara të palëve në raste katastrofash natyrore dhe ato të shkaktuara nga dora e njeriut.

2. Kjo Marrëveshje do të aplikohet në rast katastrofash natyrore dhe ato të krijuara nga dora e njeriut, të cilat nuk mund të eliminohen vetëm me forcat që kanë palët.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllimin e Marrëveshjes së paraqitur, frazat e mëposhtme do të kenë domethënien e tyre të përcaktuar si vijon:

"Ndihmë", gjëra të nevojshme, materiale, personel dhe shërbime, të siguruara nga pala asistuese duke njohur nevojat e palës kërkuese.

"Pala asistuese", pala e cila siguron ndihmë.

"Grupi i ndihmës", grupi i specialistëve të palës asistuese, të cilët kujdesen për të dhënë ndihmë dhe për të pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme.

"Organet kompetente", agjencia e caktuar nga secila palë për menaxhimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve, lidhur me zbatimin e marrëveshjes së paraqitur.

"Fatkeqësi", një ngjarje në një zonë të caktuar, e cila ka ndodhur si rezultat i një aksidenti, fenomeni të rrezikshëm natyror, katastrofe natyrore apo e shkaktuar nga dora e njeriut, që mund ose u kanë shkaktuar njerëzve ose mjedisit dëmtim të madh fizik, social, ekonomik dhe kulturor.

"Emergjencë", një situatë, shpesh e rrezikshme, e cila del papritur dhe kërkon një veprim të menjëhershëm.

"Zonë emergjente", zona në të cilën ka ndodhur një situatë emergjente.

"Reagim emergjent", kontroll, shpëtim dhe veprimtari të tjera urgjente rikuperuese, të ndërmarra në rast emergjencash, me qëllim shpëtimin e jetëve dhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, të minimizimit të dëmeve ambientale, kulturore dhe materiale për aq kohe sa rrezikon një impakt dytësor në zonat emergjente.

"Aparatura materiale", pajisje teknike dhe transporti, municione të grupit të shpëtimit dhe vegla individuale për anëtarët e tij.

"Mjetet e shpëtimit", materiale rezervë të shpërndara falas dhe pa taksa e këtyre materialeve ndër popullsinë e prekur nga fatkeqësia.

"Informacion personal", të gjitha llojet e informacioneve të personit fizik, i cili ka lidhje me situatën e pashmangshme emergjente, subjekt i kësaj marrëveshjeje.

"Pala kërkuese", pala e cila kërkon ndihmë.

"Aktivitete studimore dhe shpëtuese", aktivitete me qëllim shpëtimin e njerëzve dhe mbrojtjen e vlerave materiale, kulturore dhe ambientale në zonat e emergjencës, duke qenë se këto janë caktuar nga organet kompetente ndërkombëtare.

"Shtete transit", çdo shtet, qeveria e të cilit është pjesë, ndryshe nga pala kërkuese apo pala asistuese, nëpërmjet territorit të të cilit, duke përfshirë hapësirën ajrore dhe/ose territorin ujor, grupi i ndihmës transporton pajisjet dhe gjërat e nevojshme për ndihmë.

Neni 3

Parimet

1. Palët do të bashkëpunojnë, në përputhje me dispozitat ligjore të kësaj Marrëveshjeje, si dhe me rregulloret dhe parimet ndërkombëtare të njohura, me qëllim për të siguruar informacionin përkatës dhe të shpejtë dhe ndihmën në rast katastrofash natyrore dhe ato të shkaktuara nga dora e njeriut dhe/ose gjasat që ato mund të ndodhin.

2. Nëse një palë kërkon ndihmë në rast katastrofash natyrore dhe ato të shkaktuara nga dora e njeriut, që kanë ndodhur në territorin e shtetit të kësaj pale, ajo mund të kërkojë ndihmë nga pala (palët) e tjera duke dërguar kërkesë kombëtare. Pala asistuese do të ndihmojë palën kërkuese me mjete dhe masat që kanë për qëllim parandalimin dhe/ose eliminimin e pasojave nga katastrofat.

3. Palët do t'i japin ndihmë njëra-tjetrës sipas mundësive që kanë. Ndihma do të jepet falas në rast se nuk bihet dakord ndryshe nga palët.

4. Pala kërkuese do të sigurojë marrjen dhe shpërndarjen ekskluzivisht të ndihmës te popullsia e prekur. Ndihma do të shpërndahet pa diskriminim race, besimi, gjuhe, faktorëve politikë dhe faktorëve të tjerë.

Neni 4

Kërkesa për ndihmë dhe shkëmbim informacioni

1. Palët do të jenë organet e autorizuara për të kërkuar ndihmë në rast të një situate emergjente.

2. Ndihma do të jepet pas marrjes së kërkesës, ku pala kërkuese specifikon:

- vendin, kohën, llojin dhe shkallën e katastrofës dhe gjendjen aktuale të situatës emergjente në vendin e prekur;

- veprimet e ndërmarra, specifikimin e ndihmës së kërkuar, përcaktimin e prioriteteve të ndihmës së kërkuar si pasojë e katastrofës.

3. Pala asistuese do të marrë menjëherë një vendim për të dhënë ndihmë dhe të informojë palën kërkuese mbi mundësinë, masën dhe kushtet e dhënies së ndihmës.

4. Informacioni i përmendur në pikën 2 të këtij neni do të rifreskohet sipas zhvillimit të situatës.

Neni 5

Transiti

Me kërkesë të palës kërkuese, qeveria e vendit transit do të sigurojë të gjithë mbështetjen e nevojshme gjatë kalimit të ndihmës në territorin e shtetit të saj sipas legjislacionit të saj kombëtar, të drejtën dhe praktikën ndërkombëtare.

Neni 6

Organet kompetente dhe pikat e kontaktit

1. Palët do të caktojnë (ose vendosin) një ose disa organe kompetente të referuara si organe kompetente për të koordinuar punën lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Pa cenuar marrëveshjet e tjera ekzistuese dy dhe shumëpalëshe, palët do të caktojnë ose vendosin një ose disa pika kontakti kombëtare për të njoftuar dhe për të dhënë ndihmë në rast situatash emergjente.

3. Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përcaktimin ose ndonjë ndryshim lidhur me organin (organet) kompetent, si edhe mbi pikën (pikat) e kontaktit.

4. Palët do të sigurojnë funksionim të vazhdueshëm të organit (organeve) kompetent dhe pikës (pikave) të kontaktit.

Neni 7

Grupi i punës (komiteti) mbi situatat emergjente

Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kombëtare kompetente do të caktojnë përfaqësuesit e tyre te një organ përkatës të përbashkët (Komiteti i Grupit të Punës mbi emergjencat) që ngrihet brenda kuadrit të BEDZ-it.

Neni 8

Koordinimi dhe menaxhimi i ndihmës në rast situatash emergjente

1. Organi kompetent i palës kërkuese do të koordinojë, menaxhojë dhe mbikëqyrë aktivitetet e ekipeve të ndihmës nëpërmjet drejtuesve të tyre.

2. Pala kërkuese do të informojë drejtuesit e ekipit të palës asistuese mbi zhvillimin e situatës në zonën emergjente dhe mbi kryerjen e të gjitha aktiviteteve dhe nëse është e mundur, do t'i sigurojë këto ekipe me përkthyes dhe mjete komunikimi.

3. Pala kërkuese do të informojë drejtuesit e ekipit të ndihmës të palës asistuese rreth ndryshimeve të situatës në zonën ku ndodh situata emergjente dhe do të përcaktojë vazhdimësinë e veprimeve dhe nëse është e nevojshme, do të sigurojë përkthyes dhe të tjera mjete komunikimi me zyrën kryesore, që drejton të gjithë aktivitetet e kërkim-shpëtimit dhe aktivitete të tjera urgjente.

4. Ekipet e ndihmës duhet të jenë të vetëpajisura mjaftueshëm për të funksionuar në zonën e situatës emergjente për së paku 72 orë prej momentit të mbërritjes së tyre. Kur kalon ky afat, pala kërkuese, me kërkesën që merr nga ekipet, do të rifurnizojë këto ekipe me të gjitha mjetet e nevojshme.

5. Pala kërkuese do të kujdeset për sigurinë e ekipeve të ndihmës apo individëve-ekspertëve dhe sipas rastit, do të sigurojë përkujdesje mjekësore emergjente, ushqim, akomodim, si edhe produkte bazë për ekipet dhe ekspertët, nëse ata harxhojnë furnizimet e tyre.

Neni 9

Procedura

Procedurat për kalimin në kufi dhe rregullat e qëndrimit për skuadrën asistuese

1. Procesi për kalimin e kufijve shtetërorë të palës së kërkuar ose të shtetit transit nga pjesëtarët e ekipeve të ndihmës duhet të vendoset nga legjislacioni i tyre kombëtar, e drejta ndërkombëtare dhe marrëveshjet dypalëshe të shtetit kërkues dhe/ose shtetit transit.

2. Urdhri për procedurën e kalimit nëpërmjet kufijve shtetërore të palës së kërkuar të grupeve të qenve të kërkimit dhe qëndrimin e tyre në territorin e shtetit të palës kërkuese do të përcaktohet në çdo rast në përputhje me rregullat në fuqi mbi karantinën, të territorit të shtetit të palës së kërkuar.

3. Anëtarët e ekipit të ndihmës janë të detyruar të ndjekin ligjet dhe rregullat e shtetit të palës kërkuese dhe/ose shtetit transit. Në të njëjtën kohë ata ndodhen nën juridiksionin e palës asistuese lidhur me legjislacionin e punës dhe legjislacione të tjera përkatëse. Në rast se ekipet e ndihmës përfshijnë personelin paraushtarak të mbrojtjes ushtarake dhe civile, qëndrimi i tyre, siç bihet dakord paraprakisht, si dhe aktivitetet do të bien në legjislacionin e palës asistuese duke rregulluar statusin e çdo personeli.

4. Për qëllime të transportimit të ekipeve të ndihmës, pajisjet dhe ushqimet e tyre të ndihmës, si dhe automjetet e përshtatshme mund të përdoren me qëllim për të mbërritur në destinacion sa më shpejt të jetë e mundur. Urdhri për përdorimin e mjeteve të specifikuara të transportit për mundësimin e ndihmës do të përcaktohet nga organet kompetente të palëve.

Neni 10

Eksporti, importi dhe kalimi transit i aparaturave dhe mjeteve të shpëtimit

1. Aparaturat dhe mjetet e shpëtimit të eksportuara dhe të importuara për ndihmë në përputhje me këtë Marrëveshje do të përjashtohen nga taksat doganore, si dhe nga taksa dhe pagesa të tjera.

2. Inspektimi doganor dhe kontrolli i aparaturave dhe i mjeteve të shpëtimit do të kryhet në një mënyrë të thjeshtëzuar mbi baza prioritare, pas njoftimeve të dhëna nga organet kompetente të palëve, ku

specifikohet një strukturë mbi ekipet e ndihmës dhe një listë me aparaturat dhe mjetet e eksportuara ose të importuara për ndihmën.

3. Përbërësit narkotikë dhe substancat psikotrope mund të importohen vetëm në sasitë e nevojshme për qëllime të ndihmës mjekësore dhe të përdoren vetëm nga personeli i kualifikuar mjekësor. Në këtë rast drejtuesi i ekipit të ndihmës do t'u dorëzojë organeve të kontrollit doganor një deklaratë, ku përfshihet një listë me përbërësit narkotikë dhe substancat psikotrope, duke treguar nomenklaturën dhe sasinë e tyre. Autoritetet përkatëse të palës së kërkuar mund të kontrollojnë përdorimin dhe ruajtjen e përbërësve narkotikë dhe substancave psikotrope të përmendura sa më lart. Lëndët narkotike dhe substancat psikotrope që nuk përdoren gjatë misionit, do të merren nga territori i shtetit të palës së kërkuar. Pas përfundimit të misionit, organeve të kontrollit doganor do t'u dorëzohet certifikata mbi përbërësit narkotikë dhe substancave psikotrope të përdorura, nënshkruar nga drejtuesi dhe farmacisti i skuadrës së asistencës dhe certifikuar nga përfaqësuesi i organit kompetent të palës së kërkuar.

Neni 11
Mjetet ajrore

1. Transportimi i ekipeve, aparaturave dhe mjeteve të ndihmës mund të kryhet nëpërmjet mjeteve ajrore.

2. Organi kompetent i palës asistuese do të informojë organin kompetent të palës kërkuese mbi vendimin për të përdorur mjetin ajror për të mundësuar ndihmën duke treguar edhe zonën e hedhjes ajrore, rrugën e flurimeve, llojin dhe shenjat përkatëse të mjeteve ajrore, numrin e anëtarëve të ekuipazhit, llojin e ngarkesës, orarin e fluturimeve dhe listën e pasagjerëve (personeli, stafi teknik, gazetarë etj.).

3. Fluturimet e mjetit të lundrimit ajror, civil ose shtetëror do të kryhen në përputhje me Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil dhe rregulloret e palëve. Për mjetet e lundrimit ajror shtetëror, kërkohet leja diplomatike.

4. Pala asistuese përjashtohet nga detyrimi për të paguar për fluturimin, uljen në tokë, parkimin, ngritjen për fluturim dhe shërbimet e pilotimit, që mundëson ndihmë për situatën emergjente, subjekt i kësaj Marrëveshjeje.

5. Për fluturimin që kryhet për të siguruar ndihmë për ngjarjen emergjente, rimbursimi për karburantin, shërbimet e mirëmbajtjes së mjetit të lundrimit ajror do të vendosen veçmas sipas çdo rasti të veçantë.

Neni 12
Ndihma

1. Dhënia e ndihmës do të kryhet sipas parimeve të përshkruara në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13
Rimbursimi i shpenzimeve të ndihmës në rast të një situate emergjente e siguruar në baza kompensimi

1. Pala kërkuese mund të anulojë kërkesën e saj për ndihmë në çdo kohë. Pala kërkuese njofton palën asistuese menjëherë mbi vendimin e saj dhe pala asistuese mund të kërkojë rimbursimin e shpenzimeve që janë bërë deri në atë moment.

2. Pala asistuese do të sigurojë kontratë sigurimi për anëtarët e ekipeve të ndihmës dhe këto shpenzime do të përfshihen në faturën totale për ndihmën.

3. Me përfundimin e operacionit, organi kompetent i palës asistuese do të informojë menjëherë me shkrim organin kompetent të palës kërkuese mbi masën e ndihmës së dhënë.

4. Organi kompetent i palës kërkuese do t'i sigurojë organit kompetent të palës asistuese informacionin përfundimtar mbi karakteristikat dhe shkaqet e situatës emergjente, formën dhe masën

totale të asistencës të dhënë dhe rezultatet e punës së kryer.

Neni 14
Rimbursimi për dëmtimet

1. Pala kërkuese do të mbulojë të gjitha shpenzimet lidhur me dëmtimin ose vdekjen e pjesëtarëve të ekipeve të ndihmës, që ndodh gjatë aktiviteteve lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Palët e interesuara do të bien dakord mbi shumën që do të rimbursohet.

2. Nëse një pjesëtar i ekipit të ndihmës i shkakton dëmtim një entiteti ligjor ose personi fizik në territorin e palës kërkuese gjatë aktiviteteve lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, dëmtimi do të rimbursohet nga pala kërkuese sipas rregulloreve ligjore në fuqi, duke qenë se ky dëmtim është shkaktuar nga shtetasit e saj gjatë kohës që sigurojnë ndihmën.

3. Dëmtimi i shkaktuar nga një pjesëtar i ekipit të ndihmës, me qëllim ose neglizhencë të rëndë, do të rimbursohet nga pala kërkuese, nëse fakti mbi dëmtimin provohet nga një gjykatë kombëtare e palës kërkuese.

Neni 15
Transferimi i të dhënave personale

Transferimi i të dhënave personale te palët e tjera brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje do të kryhet sipas shtojcës 1, e cila është pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 16
Bashkëpunimi me organizata/institucione ndërkombëtare dhe kombëtare

1. Bazuar në marrëveshjen e ndërsjellë, palët përkatëse mund të ftojnë organizatat/institucionet e interesuara ndërkombëtare dhe kombëtare për t'iu bashkuar aktiviteteve, lidhur me implementimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 17
Nënshkrimi

Kjo Marrëveshje është e hapur për nënshkrim nga çdo shtet i BEDZ-it.

Neni 18
Ratifikimi, pranimi, aderimi, aprovimi ose aderimi

1. Marrëveshja do të jetë subjekt i ratifikimit, pranimit, aderimit, aprovimit ose aderimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, aderimit, aprovimit ose hyrjes do të depozitohen tek depozituesi i kësaj Marrëveshjeje.

2. Depozituesi i kësaj Marrëveshjeje do të jetë Qeveria e Federatës Ruse, e cila do të dërgojë te palët kopje të certifikuara të sa më sipër.

Neni 19
Hyrja në fuqi dhe periudha e vlefshmërisë

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi kur instrumentet e ratifikimit, pranimit, afirmimit, aprovimit ose aderimit janë depozituar nga së paku 6 shtete dhe përfshihet për një periudhë të pacaktuar kohore.

2. Për secilin shtet që ratifikon, pranon, afirmon, pranon ose aderon në këtë Marrëveshje pas depozitimit të instrumentit të gjashtë të ratifikimit, pranimit, afirmimit, aprovimit ose aderimit, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën kur shteti depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit, afirmimit, aprovimit ose aderimit.

Neni 20
Tërheqja nga kjo Marrëveshje

1. Palët mund të tërhiqen nga kjo Marrëveshje duke i dërguar një njoftim me shkrim depozituesit, i cili informon palët e tjera mbi këtë fakt.

2. Tërheqja nga Marrëveshja do të bëhet e efektshme në ditën e 90-të pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë nga depozituesi.

3. Pala që dëshiron të tërheqë daljen nga kjo Marrëveshje, do të njoftojë depozituesin me shkrim. Njoftimi do të bëhet jo më vonë se 30 ditë pas dorëzimit të aplikimit për tërheqje nga kjo Marrëveshje.

Neni 21
Ndryshimet në Marrëveshje

1. Palët mund të propozojnë ndryshime në këtë Marrëveshje.

2. Propozimi për ndryshime do t'i komunikohet Grupit të Punës (Komitetit) të Emergjencave në formë të shkruar, i përmendur në nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje, i cili më pas informon palët mbi këtë qëllim. Në rast se do të ndërmerren veprime të mëtejshme kjo do të specifikohet nga Grupi i Punës (Komiteti) i Emergjencave sipas mandatit të saj të përcaktuar nga palët.

Neni 22
Marrëdhëniet me marrëveshje të tjera ndërkombëtare

Kjo Marrëveshje nuk do të prekë të drejtat dhe detyrimet e palëve të përcaktuara në marrëveshje të tjera ndërkombëtare.

Neni 23
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet dy ose më shumë palëve lidhur me interpretimin ose aplikimin e kësaj Marrëveshjeje, palët në fjalë do të zgjidhin mosmarrëveshjen nëpërmjet negociatave dhe, nëse është e nevojshme, nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 24
Gjuha e Marrëveshjes

Teksti origjinal i kësaj Marrëveshjeje është hartuar në gjuhën angleze.

Nënshkruar në Sochi, 15 prill 1998.

Për vërtetimin e sa më sipër, kjo Marrëveshje nënshkruhet nga organet e autorizuara si më poshtë vijon:

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë
Për Qeverinë e Republikës së Armenisë
Për Qeverinë e Republikës së Azerbxhanit
Për Qeverinë e Republikës së Bullgarisë
Për Qeverinë e Republikës së Gjeorgjisë
Për Qeverinë e Republikës Helenike

Për Qeverinë e Republikës së Moldavisë
Për Qeverinë e Rumanisë
Për Qeverinë e Federatës Ruse
Për Qeverinë e Serbisë
Për Qeverinë e Republikës së Turqisë
Për Qeverinë e Ukrainës

ANEKSI I

Rregullat për shkëmbimin e të dhënave personale në kuadër të kësaj Marrëveshjeje dhe sipas legjislacionit në shtetet e palëve janë si më poshtë vijon:

1. Përdorimi i të dhënave nga pala marrëse lejohet sipas kushteve dhe për qëllimet e përshkruara nga pala dërguese.

2. Pala marrëse do të informojë palën dërguese sipas kërkesës së marrë, duke cituar se si janë përdorur të dhënat personale dhe për rezultatet që janë arritur.

3. Marrësi i të dhënave personale është vetëm organi kompetent. Rishkëmbimi i të dhënave personale mundësohet pas një lejeje me shkrim të palës dërguese.

4. Pala dërguese duhet të transferojë të dhëna korrekte, në përputhje me qëllimet e transferimit të saj, duke marrë parasysh rregulloret kombëtare përkatëse. Kur pala marrëse informohet në rast transferimi të të dhënave jokorrekte ose të klasifikuara, do të korrigjojë gabimet ose do të shkatërrojë të gjitha të dhënat.

5. Personat që pësojnë dëmtim për shkak se këto të dhëna i përkasin atij, ka të drejtë të aplikojë për një certifikatë mbi të pas prezantimit të qëllimeve për përdorimin e tyre. Nëse interesat publikë predominojnë interesat e personave të prekur, këto të fundit e humbin të drejtën e përmendur sa më lart. Në raste të tjera, personi ka të drejtë të marrë certifikatën në përputhje me legjislacionin kombëtar në shtetin, territori i të cilit ka qenë vendi i kërkesës.

6. Nëse transferimi i informacionit brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje shkakton dëmtim fizik ose moral, pala marrëse do të jetë përgjegjëse për të njëjtin faj në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar. Në trajtimin e personit (personave) që kanë pësuar një plagosje ose dëmtim të tillë, pala marrëse nuk ka të drejtë të largojë nga vetja përgjegjësinë dhe t'ia kalojë palës dërguese.

7. Periudha e vlefshmërisë së të dhënave personale duhet të njoftohet nga pala dërguese në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar.

8. Palët detyrohen të regjistrojnë të dhënat personale hyrëse dhe dalëse si dokumente zyrtare.

9. Palët detyrohen të mbrojnë të dhënat personale sipas klasifikimit të tyre kombëtar, nga hyrja, përdorimi, ndryshimet dhe zbulimi i paautorizuar.

PROTOKOLL SHTESË
I MARRËVESHJES MIDIS QEVERIVE TË VENDEVE PJESËMARRËSE TË BASHKËPUNIMIT EKONOMIK TË DETIT TË ZI (BEDZ) MBI BASHKËPUNIMIN NË NDIHMËN DHE PËRGJIGJEN NDAJ SITUATAVE EMERGJENTE NË FUSHËN E FATKEQËSIVE NATYRORE DHE ATO TË SHKAKTUARA NGA DORA E NJERIUT

Preambul

Qeveritë e vendeve anëtare të Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BEDZ) - palë në këtë protokoll shtesë, në vijim referuar si "Palët";

Bazuar mbi dispozitat e neneve 3, 4, 5, 7 dhe 8 të Marrëveshjes ndërmjet qeverive të vendeve pjesëmarrëse në Organizatën e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi mbi bashkëpunimin në ndihmën dhe përgjigjen ndaj situatave emergjente si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe ato të shkaktuara nga dora e njeriut, nënshkruar në Sochi më 15 prill 1998, në vijim referuar si "Marrëveshja BEDZ";

të vetëdijshëm mbi rolin në rritje dhe rëndësinë që kanë strategjitë efektive parandaluese në lidhje me bashkëpunimin në fushën e ndihmës ndaj situatave emergjente;

duke theksuar rëndësinë e një politike më efektive, si përgjigje ndaj fatkeqësive dhe kërkesës për bashkëpunim praktik në zvogëlimin e rreziqeve të mëdha dhe parandalimit të fatkeqësive, si dhe në rritjen e veprimit në situatat emergjente;

duke përsëritur vendosmërinë e tyre për të arritur, përmes përpjekjeve të përbashkëta, përmirësimin e zbatimit të dispozitave të marrëveshjes BEDZ;

me qëllimin për të siguruar nivelin e duhur të koordinimit të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve të palëve;

kanë rënë dakord sa më poshtë vijon:

Neni 1

Vendosja e një rrjeti oficerësh kontakti

Palët do të vendosin një rrjet oficerësh kontakti të BEDZ-it mbi asistencën emergjente, në vijim referuar si "Rrjeti", që konsiston në oficerë kontakti të caktuar nga palët si përfaqësues të tyre.

Neni 2

Objektivat

Objektivat e rrjetit janë siç vijon:

1. Të rrisë bashkëpunimin në fushën e ndihmës në situatat emergjente dhe të sigurojë koordinimin dhe ndërveprimin ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve;

2. Të vendosë një rrjet shkëmbimi informacioni ndërmjet organeve të rëndësishme të palëve për të bashkëpunuar në mënyrë efektshme në ndihmën dhe përgjigjen ndaj situatave emergjente në përputhje me marrëveshjen BEDZ.

Neni 3

Detyrat dhe funksionet

Oficerët e kontaktit të rrjetit kanë detyrat dhe funksionet e mëposhtme:

1. Të dërgojnë kërkesat që u vijnë nga oficerë të tjerë kontakti drejt vendeve të tyre respektive për raste urgjente, brenda ditës dhe për raste të tjera, brenda tri ditëve, në përputhje me dispozitat e neneve 4 dhe 5 të marrëveshjes BEDZ;

2. T'u dërgojnë palëve informacionin e kërkuar sipas kërkesës, në përputhje me dispozitat e nenit 4 të marrëveshjes BEDZ;

3. Të takohen periodikisht për të vlerësuar tendencat e asistencës ndaj situatave emergjente dhe përgjigjen ndaj situatave emergjente në rajon, me qëllim për të identifikuar forma të reja bashkëpunimi mes organeve përkatëse të vendeve anëtare të BEDZ-it;

4. T'u raportojnë dhe propozojnë organeve respektive mënyrat për të rritur më tej bashkëpunimin;

5. Të lehtësojnë shkëmbimin e eksperiencës praktike mes organeve përkatëse të palëve në fushën e asistencës dhe përgjigjes ndaj situatave emergjente.

Neni 4

Statusi i rrjetit brenda BEDZ

Rrjeti është një grup bashkëpunimi në sferën e asistencës ndaj situatave enmergjente, i krijuar në përputhje me dispozitat e nenit 7 të marrëveshjes BEDZ.

Neni 5

Vendi i takimeve të rrjetit

Rrjeti do t'i mbajë takimet në zyrat e përhershme të Sekretariatit Ndërkombëtar të BEDZ-it, nëse nuk vendoset ndryshe me iniciativën e drejtuesit të BEDZ-it ose me vendim të ministrave të punëve të

jashtme.

Neni 6
Organizimi dhe funksionimi

1. Rrjeti do të funksionojë në përputhje me kartën dhe rregullat e procedurës së BEDZ-it, si dhe dispozitat e marrëveshjes BEDZ.

2. Secila palë në këtë protokoll shtesë do të caktojë një oficer kontakti dhe alternatin e tij/saj në rrjet.

3. Pas caktimit ose tërheqjes së oficerëve të kontaktit në rrjet, palët do të njoftojnë Sekretariatin e Përhershëm Ndërkombëtar të BEDZ-it në mënyrë që të informohen të gjitha vendet anëtare.

4. Rrjeti do të mblidhet periodikisht të paktën një herë në vit.

5. Rrjeti do të kryejë detyrat e tij nën autoritetin e grupit të punës për bashkëpunim në ndihmën ndaj situatave emergjente dhe do t'i raportojë atij.

Neni 7
Shpenzimet

Të gjitha shpenzimet e oficerit të kontaktit që lidhen me implementimin e dispozitave të këtij protokolli shtesë do të përballohen nga pala dërguese.

Neni 8
Pikat kombëtare të kontaktit

Palët do të caktojnë një pikë kombëtare kontakti brenda organizmave të tyre kompetente, preferohen ata që merren me bashkëpunimin ndërkombëtar.

Neni 9
Vëzhguesit dhe të ftuarit

1. Përfaqësuesit e shteteve vëzhguese të BEDZ-it mund të marrin pjesë në punën e rrjetit, në përputhje me kartën dhe rregullat e procedurës të BEDZ-it.

2. Në mbledhjen e rrjetit mund të ftohen të marrin pjesë edhe institucione ose agjenci ndërkombëtare përkatëse.

Neni 10
Dispozitat përfundimtare

1. Ky protokoll shtesë është i hapur për nënshkrim ose pjesëmarrje nga çdo vend anëtar i BEDZ-it.

2. Sekretariati Ndërkombëtar i Përhershëm i BEDZ-it do të jetë depozituesi i këtij protokolli shtesë.

Origjinali i këtij protokolli shtesë, i përbërë nga një kopje teke në gjuhën angleze, do të depozitohet në Sekretariatin Ndërkombëtar të Përhershëm, i cili do t'i dëgojë çdo pale një kopje të certifikuar.

3. Ky protokoll shtesë do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës, në të cilin dokumenti i tretë i ratifikimit ose miratimit depozitohet në Sekretariatin Ndërkombëtar të Përhershëm të BEDZ-it.

4. Për secilën palë, që ratifikon, miraton ose merr pjesë në këtë protokoll shtesë, pas depozitimit të dokumentit të tretë të ratifikimit, miratimit ose pjesëmarrjes, ky protokoll shtesë do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit të dokumentit të ratifikimit aprovimit ose pjesëmarrjes nga kjo palë.

5. Çdo palë mund të heqë dorë nga ky protokoll shtesë me një njoftim me shkrim dërguar Sekretariatit Ndërkombëtar të Përhershëm të BEDZ-it. Heqja dorë do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës në të cilën merret njoftimi i heqjes dorë nga Sekretariati Ndërkombëtar i Përhershëm.

6. Çdo palë mund të propozojë amendime për këtë protokoll shtesë. Amendimet do të pranohen me miratimin e të gjitha palëve dhe do të hyjnë në fuqi në përputhje me paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni.

7. Dy vjet nga hyrja në fuqi e këtij protokolli shtesë, palët do të procedojnë me një analizë të rezultateve të zbatimit të dispozitave të këtij protokolli shtesë. Një vlerësim final do të bëhet katër vjet pas hyrjes në fuqi, me qëllimin për të arritur të bihet dakord për masat e nevojshme për përmirësimin e mëtejshëm të bashkëpunimit.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë
Për Qeverinë e Republikës së Armenisë
Për Qeverinë e Republikës së Azerbxhanit
Për Qeverinë e Republikës së Bullgarisë
Për Qeverinë e Republikës së Gjeorgjisë
Për Qeverinë e Republikës Helenike
Për Qeverinë e Republikës së Moldavisë
Për Qeverinë e Rumanisë
Për Qeverinë e Federatës Ruse
Për Qeverinë e Serbisë
Për Qeverinë e Republikës së Turqisë
Për Qeverinë e Ukrainës